



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3089/ 2 prot

Datë 14.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MFIInvest Group” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me nr REF-78565-08-29-2023 me objekt “Rikonstruksion i objekteve egzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në shkollën e mesme të bashkuar Remas” me fond limit 92,428,214.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-09-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjake.
- Ankimues:** BOE ‘MFIInvest Group’ SHPK nr NIPT J71830010R dhe Arkonstudio SHPK  
*Autotrada Tirane-Durres, Km 9 zona kadastrale 2005 nr pasurie 1/94 ( pranë OST-Se) Kashar*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Divjake  
Lagjia nr.2, Sheshi “Santa Barbara”

Në datën 13.12.2023 në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi me nr 3089 e BOE ‘MFIInvest Group’ SHPK dhe Arkonstudio SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr REF-78565-08-29-2023 me objekt “Rikonstruksion i objekteve egzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në shkollën e mesme të bashkuar Remas” me fond limit 92,428,214.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-09-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjake

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “MFIInvest Group” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat BOE MFInvest Group SHPK dhe Arkonstudio SHPK në ankesën nr. 3089 datë 13.12.2023 , pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

- Bilanci vjetor, për vitin financiar 2020, i paraqitur nga shoqëria “MF INVEST GROUP” Shpk, rezulton të ketë mospërputhje të pasqyrave financiare midis aktiveve dhe pasiveve në vlerat totale të tyre. Pra nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, siç është kërkuar në DST.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 14.12.2023

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**